

Бр./Nr. 04-964/1
26.06.2026 год./viti
СКОПЈЕ - SHKUP



Në bazë të nenit 4 të Ligjit për Praktikantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19, 103/21 dhe 86/25), si dhe në lidhje me Vendimin e Bordit Drejtues të Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale nr. 02-911/4 të datës 15.06.2026, Drejtoria për Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale shpall:

**KONKURS PUBLIK PËR PRAKTIKANTË
NË DREJTORINË PËR ZONAT ZHVILLIMORE TEKNOLOGJIKE INDUSTRIALE
NR. 01/2026**

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për praktikën ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19, 103/21 dhe 86/25), Drejtoria për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik shpall KONKURS PUBLIK për angazhimin e 3 (tre) praktikantëve në njësitë organizative në vijim:

- 1 (një) praktikant në Sektorin për menaxhimin e burimeve në Departamentin për çështje financiare, student i ciklit të parë të studimeve nga fusha e shkencave ekonomike;
- 1 (një) praktikant në Sektorin për punë të përgjithshme, normative dhe furnizime Publike në Departamentin për furnizime publike, student i ciklit të parë nga fusha e shkencave ekonomike;
- 1 (një) praktikant në Sektorin për analizë, negociata dhe ndjekje të kontratave për ndihmë shtetërore, student i ciklit të parë nga fusha e shkencave ekonomike.

Puna praktike do të realizohet në ambientet e Drejtorisë për Zonat Zhvillimore Teknologjike-Industriale.

Kohëzgjatja e punës praktike, orari i punës dhe kompensimi:

Periudha e praktikës do të zgjasë 3 (tre) muaj me orar të plotë pune. Orari i praktikantëve është 40 (dyzet) orë në javë, nga e hëna deri të premten, me fillim nga 07:30–08:30 dhe përfundim deri në 15:30–16:30. Për praktikën do të paguhet kompensim mujor neto në vlerë prej 42% të pagës minimale neto, të përcaktuar sipas ligjit.

Kushtet që duhet të plotësojë praktikanti:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të mos jetë në marrëdhënie pune;
- Të mos jetë më i vjetër se 34 vjeç;
- Të jetë student i ciklit të parë të studimeve;
- Të posedojë aftësi të mira komunikimi;
- Të ketë vetëiniciativë, vendosmëri dhe dëshirë për të mësuar;
- Të ketë njohuri solide të gjuhës angleze;
- Të zotërojë njohuri në përdorimin e paketës Microsoft Office.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Biografi e shkurtër (CV) me numër kontakti dhe adresë;
- Shtetësia;
- Dëshmi për statusin e arsimit që është duke e ndjekur (vërtetim nga fakulteti amë që kandidati është student i ciklit të parë);
- Vërtetim nga Agjencia për Punësim që personi është i papunë;
- Dokument i plotësuar për dërgim në praktikë nga institucioni arsimor, i shtypur në memorandum zyrtar dhe i vërtetuar me nënshkrim dhe vulë të institucionit arsimor.

Qëllimet e pritshme nga praktikantët tanë:

- Qasje e përgjegjshme ndaj detyrave dhe pjesëmarrje aktive në procesin e praktikës;
- Shfaqje iniciative dhe kreativitet;
- Dëshirë për përfitimin e aftësive praktike të punës;
- Përfitim i njohurive praktike, aftësive profesionale dhe përvojës së punës përmes pjesëmarrjes aktive në proceset e punës së Drejtorisë.

Procesi i punës praktike:

Puna praktike do të realizohet përmes pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e përditshme të punës në sektorin përkatës, nën mentorim dhe mbikëqyrje nga një person i caktuar. Praktikantëve do t'u sigurohet mbështetje e përshtatshme, udhëzime dhe mundësi për përfitimin e njohurive nga fusha përkatëse si dhe aftësi profesionale gjatë gjithë kohëzgjatjes së angazhimit praktik.

Detyrat gjatë realizimit të punës praktike:

Detyrat e praktikantëve do të përfshijnë pjesëmarrje në aktivitetet e vazhdueshme të sektorit përkatës, kryerjen e detyrave bazike të punës nën mentorim, si dhe mbështetje të ekipit në

realizimin e obligimeve të përditshme të punës. Detyrat konkrete do të përshtaten në përputhje me nevojat dhe procesin e punës së sektorit në të cilin është angazhuar praktikanti.

Mënyra dhe afati i aplikimit:

Nëse jeni në kërkim të fillimit të karrierës tuaj në një ambient pozitiv dhe dinamik, me mundësi për rritjen e njohurive dhe aftësive tuaja, dhe nëse keni interes të fitoni njohuri nga fusha e veprimtarisë së Drejtorisë për Zonat e Zhvillimit Industrial Teknologjik ju ftojmë të aplikoni në shpalljen publike dhe të dërgoni CV-në tuaj, e cila së bashku me dokumentet shoqëruese të kërkuara duhet të dorëzohet në adresën e e-mail-it: hr@fez.gov.mk.

Kandidatët e paraqitur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë, pas së cilës do të realizohet përzgjedhja përfundimtare dhe nënshkrimi i kontratës për praktikë..

Shpallja zgjat 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

Aplikimet dhe dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i paplotë ose jo i kompletuar nuk do të shqyrtohen. Pas përfundimit të afatit për aplikim, kandidatët do të njoftohen për rrjedhën e mëtejshme të procedurës.

Me kandidatët e përzgjedhur do të lidhet kontratë për punë praktike, në përputhje me nenet 12 dhe 13 të Ligjit për Praktikantë.

Drejtori

Dr. Goce Dimovski

